

GJYKATA THEMELORE NE FERIZAJ - departamenti i pergjithshem-divizioni civil, me gjyqtarin Enes Mehmeti dhe procesmbajtesen Minrie Krasniqi , ne ceshtjen e inicuar me padine e paditesit [REDACTED] nga Ferizaj rr [REDACTED] nr [REDACTED] kunder te paditurit [REDACTED] [REDACTED] me pare nga Ferizaj, tani me adrese te panjohur te cilet i perfaqeson perfaqesuesi i perkohshem av. [REDACTED] nga Ferizajj, per vertetim pronesie, ne séance e mbajtur me date 12.08.2016, ne pranine e te paditesit dhe perfaqesuesit te perkohshem, ne te njejtën dite merr kete:

A K T G J Y K I M

- ne baze te pohimit -

APROVOHET kërkesëpadia e paditësit [REDACTED] nga Ferizaj, dhe VËRTETOHET se paditësi është pronar i ngastres kadastrale numer 324-3 ZK Ferizaj me sipërfaqe prej 450 m2 oborr dhe 109 m2 , sipërfaqe e cila deshifrohet me kordinatat e caktuara nga matjet gjeodezike nga numrat 1 deri ne 10, sipas ekspertizes se dates 22.06.2016 ekspertit [REDACTED]

OBLIGOHET i padituri [REDACTED] që paditësit t'ia njohin te drejtën e pronësisë mbi këtë pronë dhe lejojnë regjistrimin e saj ne regjistrat kadastral në emër të paditësit këtë në afat prej 15 ditësh pas pranimit te kopjes së tij, në të kundërtën ky aktgjykim do t'i shërben paditësit ai autorizim për të bërë regjistrimin e pronës në emër të tij.

OBLIGOHET paditësi që të bëjë pagesën e shpenzimeve për përfaqësim nga përfaqësuesi e perkohshëm i të paditurit si dhe taksën për aktgjykim ne shume prej 50.00€, ne afat prej 15 ditesh pas pranimit te ketij aktgjykimi.

A r s y e t i m i

Paditesi ka pretenduar me padi se ne vitin 1980, babai i tij [REDACTED] ka blere pronen kontestuese qe shtrihet ne ngastrat kadastrale numer 324-3 ZK Ferizaj dhe se ka permbushur ne teresi detyrimet lidhur me pagesen e cmimit dhe ka marr ne posedim te papenguar pronen nga te paditurit qe nga viti 1980 e tutje. Ka kerkuar t'i njihet e drejta e pronesise mbi bazen e mbajtjes me mirebesim.

Gjykata, fillimsht, ka aprovuar propozimin e paditësit që të paditurit t'i caktohet perfaqesuesi i perkohshem, meqenese e njejta eshte shperngulur jashte Kosoves dhe nuk kane e as qe mund te sigurojne ndonje informacion, per vendndodhjen e saj.

Gjykata aktvendimin per caktimin e perfaqesuesit te perkohshem e ka publikuar ne gazeten zyrtare te Republikes se Kosoves dhe ne tabelen e shpalljeve te kesaj gjykate.



Perfaqesuesi i perkohshem av. [REDACTED] nga Ferizaj ne seancen e shqyrtimit kryesor, ne fjalen e tij perfundimtare nuk ka kontestuar kerkesepadinë e paditësit që paditësi të shpallet pronar i pronës kontestuese.

Gjykata ka aprovuar kërkesepadinë e paditësit si të pohuar duke qenë se në mes palëve ndërgjyqjese nuk ishin kontestuese faktet vendimtare të çështjes dhe se perfaqesuesi i te paditureve shprehimisht ka pranuar kerkesepadine dhe në anën tjetër, gjykata nga shqyrtimi i gjithmbarshëm i çështjes nuk ka gjetur ndonjë rrethanë, për të cilën duhet kujdesur kryesisht e e cila do te pengonte aprovimin e kërkesepadisë dhe rrethana tjera që t'i vënte në kundërshtim faktet dhe provat e çështjes me pohimin e kërkesepadisë nga ana e përfaqësuesit të përkohshëm të te paditureve, ndaj ne kuptim te nenit 148, ka nxjerr aktgjykim në bazë të pohimit.

Gjykata me qellim te vertetimi te rrethanave lidhur me poziten dhe shtrirjen e prones kontestuese ka bere identifikimin e saj permes ekspertit te gjeodezise me ane te te cilit ka percaktuar paramasat dhe kufizimet e prones objekt kontesti, nga ku ka sqaruar siperfaqen e prones objekt konteskti, pozicionimin e saj- shtrirjen kadastrale ne zone, pronaret juridik te saj dhe shfrytëzuesi aktual te saj dhe per keto te gjetura te ekspertizes gjykata i ka pranuar ne teresi si professional dhe ne perputhje me gjendjen faktike dhe zyrtare.

Shpenzimet e procedures per perfaqesim te te paditureve nga perfaqesuesi i perkohshem gjykata ia ka ngarkuar paditesit ne kuptim te nenit 81 par.2 lidhur me nenin 453 te LPK-se, ndersa per taksen per aktgjykim ne shume prej 50.00€, ne baze te nenit 445 te LPK-se.

Mbi bazën e parashtrimeve te mesiperme eshte vendosur si ne dispozitiv te ketij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NE FERIZAJ

C.nr.580/12 date 12.08.2016



Gjyqtari,
Edis Mehmeti

Keshilla juridike: Kunder ketij aktgjykimi mund te ushtrohet ankese ne afat prej 15 ditesh, pas pranimit te tij, ne gjykatën e Apelit ne Prishtine, permes kesaj gjykate.

